



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 639-640/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Agon Ramadani- Kryetar, Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik "DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D"/SH.P.K Adresa - Prishtinë, dhe ankesës së OE "CLEAN TEAM SH.P.K", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor", me nr. të prokurimit: 616-22-10416-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës, me datën 20.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I **APROVOHET** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D"/SH.P.K Adresa - Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 10.11.2022 me numër të protokollit 639/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor", me nr. të prokurimit: 616-22-10416-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës.

II. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "CLEAN TEAM SH.P.K", e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 10.11.2022 me numër të protokollit 640/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor", me nr. të prokurimit: 616-22-10416-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës.

III. **OBLIGOHET**, AK për aktivitetin prokurimit të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, të bëjë korrigjimin në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje e Tenderit dhe të zgjaten afatet në përputhje me Nenin 53 pika 7 të LPP-së.

IV. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

V. Me qenë se ankesat e OE ankues aprovohen si pjesërisht të bazuara, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me 28.09.2022, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës, ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me nr. të prokurimit: 616-22-10416-2-1-1.

Me datën 08.11.2022 Autoriteti Kontraktues – Komuna e prishtinës ka publikuar Njoftimin mbi korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

Me 08.11.2022 OE “DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D/SH.P.K Adresa - Prishtinë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, AK ka hedhur poshtë sit ë palejuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.11.2022 OE “DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D/SH.P.K Adresa - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 639/22), kundër njoftimit për kontratë të cituar si më sipër.

Me 25.10.2022 OE “CLEAN TEAM SH.P.K”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, AK pas 14 ditëve ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën për rishqyrtim, respektivisht me datën 08.11.2022.

Me 10.11.2022 OE “CLEAN TEAM SH.P.K ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 640/22), kundër njoftimit për kontratë të cituar si më sipër.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim nënin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 24.11.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

- Ankesa e OE “DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D/SH.P.K Adresa - Prishtinë të aprovohet pjesërisht e bazuar;
- Ankesa e OE “CLEAN TEAM SH.P.K”, të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Të korrigjohen NJK dhe DT, të zgjaten afatet në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e kësaj dosje sqaron si në vijim: Pas analizimit të dokumentacionit të dorëzuar nga OE-të ankues “DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D”SH.P.K. Adresa - Prishtinë, dhe OE “CLEAN TEAM” SH.P.K. - Lipjan si dhe dokumenteve të cilat janë pjesë e këtij aktivitetit të prokurimit të cilat po shtjellojmë si me poshtë:

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të tërë dokumentacionit i cili është pjesë e këtij Aktivitetit të Prokurimit sqaron së AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në *Nenin 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit pika. 7 Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e -procedurave të hapura, të kufizuara ose konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtër se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre. Nëse një operator ekonomik ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do ti lejohet që të dorëzojë një përmirësim për tenderin përkatës, por përmirësimi i tillë kufizohet vetëm në ndryshimet që janë të lidhura me informatat e tilla të arsyeshme sqaruese ose shtesë, dhe në Kundërshtim me RRUOPP-në neni 18. Dosja e Tenderit pika 18.4 Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. Neni 22. Publikimet pika e. Njoftim për informata shtesë ose përmirësim gabimi • Nëse një AK siguron informata shtesë për Operatoret ekonomik ose bënë një përmirësim të gabimit ose zgjate afatin e dorëzimit të tenderit, gjate udhëheqjes se Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 46 aktivitetit të prokurimit përmes procedurës së hapur, kufizuar, konkurruese me negociata ose kuotim të çmimit, ZP do të përgatis Njoftimin për informata shtesë, duke përdorur formularin standard B54 të aprovuar nga KRPP. Dhe Neni 25. Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore pika 25.5 Nëse, gjatë një procedure të hapur, të kufizuar apo konkurruese me negociata, informata shtesë apo sqaruese ofrohen për OE-të, dhe data kur ofrohen këto informata është më pak se dhjetë (10) ditë nga afati i fundit për dorëzim të tenderit, AK do të zgjatë afatin kohorë për të dhënë mundësi OE të paktën 10 ditë për dorëzimin e tenderëve duke përgatitur dhe publikuar Njoftimin për Korrigjim te procedurës. Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par. 1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet së*

"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparent",

Konstatuar në elaborimet e lartë shënuara Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka zgjatur afatin pas sqarimeve të fundit gjë e cila nuk është në harmoni me rregullativën ligjore mbi prokurimin publik në Republikën e Kosovës të lartcekur, pretendim ankimor i OE-vë ankues është i bazuar. Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës duhet që të evitoj shkeljet e lëshuara dhe ti harmonizoj me LPP dhe RRUOPP.

Eksperti shqyrtues, sqaron së AK ndryshimin e Kriterit për Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të lartë shënuara Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk e ka bërë përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet dhe as Dosjes së Tenderit Por ndryshimin e ka sqaruar vetëm në vendim të Aprovimit të kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE "Samire Osman" B.I dhe në Vendim të Refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE CLEAN TEAM SH.P.K.

Gjë e cila është në kundërshtim me LPP-në dhe RRUOPP-në çështje e cila është elaboruar më lartë, pretendim ankimor i OE-vë ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Eksperti shqyrtues, sqaron së AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE CLEAN TEAM SH.P.K. nuk ka vepruar në harmoni me LPP-në Neni 108/ A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve pika 6 *Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.* Dhe në kundërshtim me Rregullat për parashtrim të ankesave neni 6 pika 6.3 *Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 6.2 të këtyre rregullave. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.*

Eksperti shqyrtues mbështetur në sqarimet e lartpërmendura konstaton se pretendimin ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.3

Eksperti shqyrtues, sqaron së AK- Komuna e Prishtinës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Kontratën Publike Kornizë - Shërbim, me një Operator Ekonomik, kontratë publike me vlerë të madhe vlera e parashikuar e kontratës: 450,000,00€ me kohëzgjatje prej 36 muaj. Dhe mbështetur në LPP dhe RRUOPP ndarja në Lote mbetet në përgjegjësi e AK -së së si të prokuroj (mund ti ndajë në lote dhe nuk është me pa tjetër) dhe ky pretendim ankimor i OE-vë ankues është i pa-bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.4

Eksperti shqyrtues, sqaron së AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës gjate këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë kufizim të lista e stafit duke kërkuar 2. Lista e punëtorëve duhet të jetë e dëshmuar dhe vërtetuar nga ATK, kjo kërkesë është diskriminuese dhe si e tillë duhet të korrigohet nga AK *citoj* "2. *Lista e stafit origjinalë e nënshkruar dhe vulosur nga OE duke bashkëngjitur kontratat ose marrëveshjet e punës valide për këtë projekt.*"¹ dhe ky pretendim ankimor i OE-vë ankues është i bazuar.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitura, pretendimet e dispozitive ligjore të shkelura, kërkesat e vendosura në Njoftim për Kontratë, Dosjes së Tenderit, B54 Formulari standard-për korrigjimin e gabimeve në njoftimet, Vendimet në Kërkesat për Rishqyrtim konsiderojmë së OE-të Ankues palë në këtë proces kanë pjesërisht të drejtë lidhur me pretendimet e ngritura, një pjese e këtyre pretendime në një analizë të mirëfilltë të provave dhe bazës ligjore dëshmojnë disa lëshime të bëra nga ana e Autoritetit Kontraktues Komuna Prishtinë dhe të njëjtat nuk janë në harmoni me sipas rregullave ligjore mbi prokurimin publik në Republikën e Kosovës, të cilat janë të elaboruara në këtë ekspertizë dhe si të tilla duhet të evitohen në këtë AP dhe mos të përsëriten nga AK në aktivitet tjera.

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-vë ankues të aprohen si pjesërisht të bazuara, ndërsa njoftimi B05 Njoftimit për Kontratë i datës 29.08.2022 dhe Dosja e Tenderit të korrigojen nga AK të zgjaten afatet në përputhje me *Nenin 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit pika.7* për t'ua mundësuar që OE të ofertojnë.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të gjitha palët me ç'rast edhe OE ankues Clean Team Sh.P.K pajtohet pjesërisht, ndërsa bazuar në shkresat e lëndës Oe ankues "Doctor Exterminator D.D.D Sh.P.K nuk ka dhënë përgjigje ndaj raportit të ekspertit shqyrtues, si dhe AK nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët në relacion me pretendimet e paraqitura ankimore, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli, andaj lidhur me pretendimet e ngritura ankimore të paraqitura përmes ankesave të tyre, arsyetimet e dhëna në raportin e ekspertizës llogariten si arsyetime të Panelit Shqyrtues, kështu që obligohet AK të bëjë përmirësimet e lartëcekura si dhe të zgjasë afatin e pranimit të ofertave konform nenit 53 të LPP-së si dhe 18, 22, 25 të RROUPP-së, gjithashtu lidhur me veprimet e ndërmarra nga AK të lartëcekura, PSH konstaton se AK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim dispozitat e LPP-së, RROUPP-së si dhe Rregullat për parashtrim të ankesave, andaj PSH përmes këtij vendimi lëshon vërejtje përfundimtare AK-së që të përmirësojë NJK si dhe DT si dhe të udhëheqë procedurat sipas dispozitive ligjore të lartëcekura në raportin e ekspertit si dhe si dhe këtij dispozitivi, në të

kundërtën OSHP do të ndërrmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP-së.

Lidhur me pretendimet mbi ndarjen e Loteve si dhe kërkesën që kriteri në qarkullimin për tri vitet e fundit mos të kaloj vlerën e parashikuar të kontratës, PSH konform raportit të ekspertizës i klasifikon si të pabazuara për faktin se ndarja apo jo në lote të aktiviteteve të prokurimit, qëndron në përgjegjësinë dhe diskrecion të AK-së ndërsa kërkesa mbi qarkullimin si dhe vlerës së kontratave të të realizuara të natyrës së ngjashme, këto janë çështje që rregullohen sipas dispozitave përkatëse që specifikojnë limitet e lejuara, kështu që gjithashtu vendim-marrja në relacion me këto pretendime mbetet në përgjegjësinë e AK-së, duke zbatuar limitet dhe kushtet e specifikuara sipas ligjit në fuqi.

Lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura nga OE ankues ku referencat kërkohen të ngjashme për deratizim, ndërsa kërkohet që të konsiderohen referencat nga fusha e DDD, PSH këto pretendime i klasifikon si të bazuara, për faktin se shërbimet e DDD ofrohen nga OE të licencuar nga MBZHR, si dhe duke pasur parasysh poashtu se këto shërbime të kësaj natyre zakonisht janë në vlera të vogla, andaj rrjedhimisht një kërkesë e tillë do të shpiente në kufizim të konsiderueshëm të konkurrencës gjë që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, gjithashtu duke u bazuar në aktivitetet e kësaj natyre deri më tani ku janë pranuar referenca/kontrata të natyrës së DDD dhe jo vetëm fushave specifike (vetëm deratizim), andaj obligohet që AK të bëjë përmirësimin e këtij kriteri duke lejuar/pranuar kontrata/referenca nga lëmi i DDD dhe jo vetëm të ngjashme me Deratizim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesues i Panelit e Shqyrtues

Z. Agon Ramadani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komuna e Prishtinës;

1x1 OE- “DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D/SH.P.K Adresa - Prishtinë”;

1x1 EO – “CLEAN TEAM SH.P.K;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.